



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 506/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë A.nr.506/2021 e datës 10.02.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.506/2025 të parashtruar nga Rrjeti Ballbanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Liridona B. Bislimi, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, më datë 09.02.2025, ditën e votimit ka publikuar në rrjetin social facebook, një deklaratë *“Nga mëngjesi e deri në mesditën e vonshme kam takuar shume vajza që votojnë për herë të parë, dhe gratë të cilat kanë vendosur të bëjnë zgjedhjen e duhur për të ardhmen tonë e të fëmijëve tanë.....Të mobilizuara si asnjëherë me pare për VETVENDOSJEN!*

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik LVV kanë bërë shkelje të nenit 37, paragrafi 1 nën paragrafi 1. të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku përcaktohet se *“1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndaloheq secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.*

Si provë parashtruesi i ankesave ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë postimin.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Ankesa është e palejuara

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Subjektit Politik LDK, Anr.487/2025 të paraqitur me datën 09.02.2025, kundër Subjektit Politik LVV, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.487/2025 të datës 11.02.2025 me të cilin Subjektit Politik LVV i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00 Euro (dymijë) Euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.487/2025 të datës 11.02.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesa.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 506/2025 më datën 12.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.